

LICENCË
Nr.9, datë 20.2.1997

E BANKËS SË SHQIPËRISË DHËNË BANKËS NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA

Banka e Shqipërisë në mbështetje të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë", nenet 7 dhe 10 të ligjit nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", nenet 6 dhe 13 dhe të vendimit nr.9, datë 30.4.1996 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Bankës Ndërkombëtare sh.a. iu dha licencë për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.

Licenca ka numër 9, datë 20.2.1997.

Ajo e lejon Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a. të kryejë veprimtaritë e mëposhtme.

1. Pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes.

2. Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun më ose pa burime ndihmë dhe financimin e transaksioneve tregtare.

3. Marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve.

a) të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë, ndër të tjera, çeqet, kambialet dhe certifikatat e depozitave);

b) të letrave me vlerë të borxhit;

c) të kontratave të "së ardhmes" dhe kontratat "e mundësive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit;

d) të instrumentave të normës së interesit.

4. Kryerjen e shërbimit të pagesës.

5. Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kanë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit).

6. Ndërmjetësim pa operacione monetare (duke përfshirë valutat).

7. Lisingu financiar.

8. Kryerjen e shërbimeve si agjent financiar ose si këshilltar financiar (jo për shërbime të përshkruara në pikën 1 dhe 2)

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.

Veprimtaria fillon menjëherë.

GUVERNATORI
Kristaq Luniku